



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Nr. 2505 Prot.

Tiranë, më 23.04 2019

Lënda: Kërkesë për plotësim dokumentacioni

ZNJ. SHQIPE VELIKO MEMUSHAJ
Adresa: Këshilli i Bashkisë Vlorë

Për dijeni: **KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË**
Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Vlorë

PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
Adresa: Sheshi "Austria", Tiranë

Me shkresën nr. 2177 prot., datë 13.03.2019, Këshilli i Bashkisë Vlorë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, në Këshill, vakancë kjo e krijuar nga Këshilltari, z. Ted Kristaq Nasto, propozuar nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Vlorë, të cilit i kalon mandati i Këshilltarit, është kandidati me numër rendor 29, znj. Najada Hajdar Shatro.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1652 prot., datë 26.03.2019, i është drejtuar znj. Najada Hajdar Shatro, me kërkesë për plotësim dokumentacioni, si kandidate vijuese e listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Vlorë, të cilës i kalon mandati i Këshilltarit.

Znj. Najada Hajdar Shatro brenda afatit të përcaktuar datës 16.04.2019, nuk ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit për garantimin e integritetit.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", kreu II, pika 3, parashikon se: "Në rastet kur procedura e kandidimit, zgjedhjes apo emërimit për pozicionet dhe subjektet e parashikuara në nenet 2 dhe 3, të ligjit, atëhere organi kompetent e njofton atë që, brenda 10 ditëve nga njoftimi, të depozitojë të plotësuar formularin e vetëdeklarimit, sipas këtij vendimi, me përjashtim kur parashikohet ndryshe me ligj. Nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim. Në këtë rast, organi kompetent ndërpret procedurën për propozimin e këtij subjekti për t'u kandiduar, zgjedhur apo emëruar në atë funksion publik.

Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të vazhdojë procedurën me kandidatin e rradhës me numër rendor 31, znj. Shqipe Veliko Memushaj.



Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për çdo kandidat të listave shumëmemërore për këshillin bashkiak për shkak të plotësimit të vakancave duhet të kryhet, vetëdeklarimi për garantimin e integritetit dhe verifikimi i të dhënave.

Përpara plotësimit të vakancës në Këshillin e Bashkisë Vlorë, kandidati i listës shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, znj. Shqipe Veliko Memushaj, duhet të depozitojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 10 ditëve formularin e vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të kandidatit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" ka vendosur të bëjë njoftimin e kandidatit, nëpërmjet afishimit publik, për shkak të pamundësisë së gjetjes së një adrese të saktë për të bërë njoftimin e saj. Kjo shpallje do të publikohet edhe në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Me afishimin e kësaj shpallje, kandidatët vihet në dijeni për njoftimin e tyre për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Afati i dorëzimit fillon nga data e publikimit të kësaj shpallje.

Nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit të sipërcituar, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim.

Ju bëjmë me dije se formulari i vetëdeklarimit duhet të jetë i plotësuar në kompjuter, në të gjitha seksionet e tij dhe në rast se ndonjë nga pjesët e formularit nuk mund të plotësohet, për mungesë të faktit, atëherë personi duhet të shënojë me vizë (/) atë pjesë, në mënyrë që të shmanget plotësimi apo rregullimi i mëvonshëm i saj, në përputhje me Kreun II, pika 7, dhe Kreun III pika 2, e Vendimit të Kuvendit nr.17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

